

Koalicioni Euroatlantik

SHQIPËRIA MERITON MË SHUMË

HYRJA

1.MIRËQEVERISJA, LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT, SUNDIMI I LIGJIT

Gjatë 12 viteve të qeverisjes socialiste, korrupsioni ka arritur në nivelet më të larta në të gjithë historinë tonë. Përditë në dyert e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) paraqiten ministra, kryebashkiakë, ish-kryeministra që kanë mbushur xhepat me paratë publike. Nga korrupsioni, Shqipëria është varfëruar, shqiptarët emigrojnë, ndërsa një grusht pushtetarësh vazhdojnë të sundojnë vendin prej 34 vitesh.

Ne e dimë që në të gjithë botën, shqiptarët janë histori suksesi. Përveçse në Shqipëri. Nuk duhet dhe nuk do të jetë më kështu!

Ne besojmë se vizioni për të ardhmen, arrihet përmes pastrimit të politikës nga korrupsioni dhe lidhjet me krimin e organizuar.

Shqiptarët meritojnë një klasë politike që punon për të zgjidhur problemet e tyre. Ata, meritojnë një administratë publike me integritet, që vepron në shërbim të tyre.

Me këtë qëllim, Koalicioni Euroatlantik do të mbështesë pa asnjë rezervë SPAK-un dhe do të vendosë në dispozicion të tij, të gjitha burimet financiare dhe njerëzore që i nevojiten.

Për ta forcuar edhe më shumë luftën kundër korrupsionit, ne do të ndërmarrim këto masa:

1. Heqjen totale të imunitetit të deputetëve për t'i hapur rrugë hetimit të plotë nga SPAK;
2. Veting të politikanëve, sipas modelit të vetingut në drejtësi;
3. Reformim të KLSH-së, duke e shndërruar atë në Gjykatë Auditi, ku:
 - a. anëtarë të saj vetohen para emërimit,
 - b. kryetari zgjidhet nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, bazuar në propozimin e opozitës,
 - c. vendimet e saj të jenë titull ekzekutiv, d.m.th. të detyrueshme për zbatim.
4. Inspektoriati Kombëtar do të reformohet duke u bërë vetëm 1 (Një) dhe do të fokusohet në tre fusha prioritare: siguria ushqimore, siguria e shëndetit publik dhe siguria teknike;
5. Aplikimi i ligjit antimafia, për verifikimin e kontratave të koncesionit të Partneritetit Publik Privat (PPP-ve) dhe të partneriteteve strategjike.

Me qëllim që të çlirojmë ekonominë, të rikuperojmë paratë publike dhe të kthejmë besimin e njerëzve tek qeverisja, në qeverinë e re ne angazhohemi për:

1. Verifikimin e kontratave koncesionare, PPP-ve, dhe Prokurimeve Publike.
 - a. Çdo kontratë korruptive do të anulohet.
 - b. Kompania që gjendet me shkelje do të përjashtohet nga procedurat konkurruese publike ose shërbimi publik për 20 vjet.
 - c. Në arbitrazh dhe në gjykatë, qeveria do të mbrohet me klauzolën e korrupsionit.
 - d. Moratorium një vjeçar, për të rishikuar të gjitha kontratat PPP-ve.
2. Çdo gjetje abuzive, do të raportohet në prokurori sipas ligjit Antimafia.
 - a. Pasuritë e personave të përfshirë në këto kontrata abuzive do të verifikohen, sekuestrohen dhe konfiskohen, pavarësisht nëse dënohen penalisht.
 - b. Barrën e provës e ka kompania private ose zyrtari që ka miratuar aktin.
3. Miliarda euro dhe pasuri të tjera të zhvatura qytetarëve dhe shtetit shqiptar do të gjurmohen, lokalizohen dhe do t'iu kthehen qytetareve përmes *Njësisë së Zbulimit dhe Rikuperimit të Pasurive* e cila, do të veprojë në çdo cep të territorit, por edhe jashtë vendit.

Sundimi i Ligjit dhe mbështetja për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Qytetarët shqiptarë rraskapiten me vite nëpër dyert e gjykatave. Mbi, 110 000 (Njëqind e dhjetë mijë) dosje gjyqësore janë në pritje të shqyrtimit. Nesër, në qeverisje, ne do ta ulim në mënyrë drastike këtë numër.

Ne angazhohemi se qeveria e re:

- a. Do të heqë dorë, nga të gjitha ankimet apo rekursat e bëra nga institucionet shtetërore kundër pensionistëve.
- b. Do të heqë dorë, nga çdo rekurs i bërë nga institucionet publike për gjyqet e marrëdhënieve të punës.
- c. Do të rishikojmë dhe zgjidhim administrativisht, çdo proces gjyqësor me palë shtetin.
- d. Kërkesat për Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit do të bëhen tek Noteri duke çliruar njerëzit dhe bizneset nga pritjet e pafundme.

Rama me qeverisjen e tij, janë bërë pengesë për funksionimin normal të organeve të reja të drejtësisë. Ai vazhdon dhe refuzon, çdo kërkesë të tyre për investime në infrastrukturën e gjykatave dhe prokurorive.

Ne, mbështesim SPAK-un dhe qëndrojmë përkrah sistemit të drejtësisë, përballë çdo sulmi që vjen nga politika dhe subjektet që janë pjesë e hetimeve të tij.

Në një vend normal, SPAK-u nuk do të ishte i nevojshëm të ekzistonte, por ai u krijua në Shqipëri pikërisht për shkak të korrupsionit të madh qeveritar.

Ne, do të plotësojmë çdo kërkesë të institucioneve të drejtësisë, duke financuar dhe ndërtuar një infrastrukturë të re moderne për t'i dhënë mundësi shtimit të burimeve njëzore.

Brenda 4 (Katër) viteve të qeverisjes sonë, ne do të ndëtojmë ndërtesa dinjitoze për Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë dhe Gjykatat e Apelit, për t'i dhënë qytetarëve aksesin dhe dinjitetin e merituar.

Në bashkërendim me Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe aktorët e tjerë të drejtësisë, ne do të rishikojmë menjëherë hartën gjyqësore, për t'i garantuar qytetarëve shqiptarë aksesin efektiv në drejtësi.

Mirëqeverisja

Në 12 (Dymbëdhjetë) vite nën drejtimin e Edi Ramës, Shqipëria shkoi në drejtimin e gabuar. Kostoja e jetesës është rritur, ndërsa pagat nuk e përballojnë dot rritjen e saj. Shqipëria ka një mori problemesh serioze dhe sigurisht që shkaktori i tyre dhe përgjegjësi kryesor është Edi Rama. Prandaj, ai nuk mund të jetë më zgjidhja!

Ky program synon ta transformojë Shqipërinë në një ekonomi të zhvilluar, të begatë dhe dinamike, që shqiptarët të bëhen ndër qytetarët më të pasur të rajonit dhe ku ata të kenë mundësi zgjedhjeje për punësim, gjenerim të ardhurash dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Për një mirëqeverisje që ofron standarde për qytetarët ne kemi vendosur:

1. Krijimin e “Sistemit të Kontratave Publike”, i cili do të përmbajë pasaportën e çdo kontrate publike nën modelin “open data”, që do të sigurojë transparencë dhe akses të lehtë, të vazhdueshëm dhe të pakufizuar në kohë, për çdo qytetar.
2. Transparencë të plotë mbi pronësinë direkte dhe indirekte në regjistrin e pronarëve përfitues.
3. Rishikim dhe anulim të ligjeve speciale për biznese me emra të përvetshëm dhe Koncesione/PPP, me pronarë të regjistruar në parajsa fikale/offshore.
4. Rritje të konkurrencës në fushën e prokurimeve publike, duke mos lejuar procedurat me më pak se tre (3) operatorë në garë dhe duke përjashtuar çdo operator pa ofertë ekonomike.
5. Krijimi i regjistrit publik të nënkontraktorëve.
6. Operatorët ekonomikë duhet të provojnë se zotërojnë të paktën 50% të kapaciteteve financiare për realizimin e projekteve koncesionare.
7. Reduktim të riskut fiskal duke ndaluar të gjitha kontratat me financim nga buxheti i shtetit

8. Vendosim parimin ONE WINDOW: Një kontakt me shtetin nëpërmjet parimit ONE WINDOW/Dritare Unike për shërbimet që ofron shteti.
9. Sistem inspektimi kombëtar, që nuk gjobit por parandalon. Inspektori vepron vetëm me checklist dhe brenda kompetencave, ai ushtron kontroll mesatarisht 6 (gjashtë) ditë në vit. Inspektimet fizike do të jenë jo më shumë se 10 %.
10. Qasja “bazuar në risk” për kontrollin/inspektimin e aktiviteteve të biznesit. Futja e vlerësimeve, kërkesave, kontrolleve të diferencuara bazuar në rrezikun e lidhur me rrezikun e aktiviteteve.
11. SISTEMI I NJOHJEVE TË NJËANSHME: do të pranohen certifikata të kontrollit/cilësisë të aplikuara nga SHBA/BE/Kanada.

Bashkitë dhe zhvillimi rajonal

Qytetarët sot, shohin sesi bashkitë janë kthyer në moçale korrupsioni dhe megaskandalesh inceneratorësh, pastrim parash dhe pasurim të pushtetarëve.

Për të nxitur lirinë ekonomike dhe menaxhimin efikas të territorit dhe pasurive lokale, si dhe për të ndalur shpopullimin e periferive të vendit, ne do të krijojmë Zonat e lira ekonomike, duke:

- Ndërmarrë një reformë të plotë administrative duke forcuar këshillat bashkiakë. Kryetarët e qendrave administrative do të zgjidhen me votë të drejtpërdrejtë dhe jo me emërim si deri më tani. Çdo njësi administrative do të përfaqësohet me të zgjedhurin e vet në Këshillin e Bashkisë.
- Shërbimet do të jenë sa më pranë qytetarit duke bërë të mundur funksionimin e zyrës **ONE WINDOW** në çdo njësi administrative, edhe në ato më periferiket.
- Do të rrisim dhe fuqizojmë rolin e qytetarëve në kërkesë llogarie ndaj të zgjedhurve vendorë.
- Buxheti i bashkive do të jetë jo më pak se 3% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së), duke e rritur atë çdo vit me 0.5% të PBB-së.

Për të rritur decentralizimin politik, institucional, dhe financiar ne gjithashtu propozojmë:

- **Krijimin e Rajoneve:** në funksion të luftës kundër korrupsionit, luftës kundër shpopullimit të vendit, zhvillimit të një ekonomie të qëndrueshme, dhe me qëllim përafrimin e modelit të ndarjes administrative sipas kritereve të BE-së për organizimin territorial të vendit, Koalicioni Euroatlantik angazhohet ta ndajë atë në **Katër Rajone**, plus **Tirana metropolitane, me kompetenca administrative.**
- Ngritjen e **Bankës Shqiptare të Zhvillimit Rajonal** kryesisht me kapitale emigrantësh dhe të diasporës sipërmarrëse, me mbrojtje shtetërore.

Administrata publike

Programi për Administratën Publike, ka në themel shërbimin profesional dhe të kualifikuar ndaj qytetarëve, si garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme. Ne do t'i rikthejmë dinjitetin nëpunësit publik duke e çliruar nga presioni i pushtetit të korruptuar.

Për një administratë publike profesionale, ne jemi të përkushtuar për:

- Kualifikimin e vazhdueshëm të administratës publike,
- Një sistem i drejtë e konkurrues,
- Mundësi për profesionistët e rinj,
- Paga dinjitoze,
- Shërbime të integruara dhe të ofruara në kohë,
- Një aplikim i vetëm që adreson problemin, vendos në lëvizje institucionet për të gjetur doemos zgjidhjen,
- Përgjegjësi politike dhe ashpërsim i masave penale ndaj çdo akti korrupsioni në administratën publike.

Demokracia dhe zgjedhjet e lira

Shqipëria ka 34 (Tridhjetë e katër) vjet, që lëngon nga një demokraci e brishtë, e korruptuar dhe jo përfaqësuese. Guri i themelit për çdo demokraci, janë vota dhe zgjedhjet e lira. Sepse, ne besojmë se mirëqeverisja fillon me votën dhe zgjedhjet e lira.

Ne besojmë në këto vlera dhe besojmë që Shqipëria meriton më shumë.

Për të bërë të mundur barazinë e votës ne depozituam në parlament propozimet për:

- Shqipërinë si një zonë zgjedhore, me të cilën garantojmë barazinë e votës për të gjithë votuesit pavarësisht vendbanimit të tyre.
- Listat e hapura, duke besuar tek vlera e individit dhe tek e drejta e qytetarëve për të zgjedhur deputetin e tyre.
- Vetingun e politikanëve, sepse Shqipëria meriton të ketë një klasë drejtuese të pakorruptuar dhe pa lidhje me krimin e organizuar.
- Votën e diasporës, sepse shqiptarët kudo jetojnë, meritojnë të ushtrojnë të drejtën e votës dhe të marrin pjesë aktive në jetën e vendit të tyre.

2.ZHVILLIMI EKONOMIK / KLIMA E BIZNESIT / TAKSAT / INVESTIMET PUBLIKE / INFRASTRUKTURA / ENERGJIA

Zhvillimi ekonomik

Shqiptarët duhet të kenë kërkesa dhe pritshmëri më të larta nga drejtuesit e tyre sepse shqiptarët meritojnë më shumë sesa kjo klasë politike 34 vjeçare, e vjetëruar dhe e kërrusur nga korrupsioni.

Pa ngritur kërkesat e pritshmëritë tona ndaj qeveritarëve, Shqipëria nuk do të bëhet asnjëherë vend i begatë dhe i zhvilluar. Nëse ulemi në shtëpi përpara televizorit e themi “mirë me kaq se ka dhe më keq” jo vetëm që nuk do të arrijmë asgjë, por ky vend do të shkojë edhe më keq. Vetëm nëse do të dimë të ngrejmë pyetjet dhe shqetësimet tona, të kërkojmë llogari, të kemi pritshmëri të larta për veten dhe vendin tonë, atëherë gjendja jonë mund të përmirësohet.

Në të gjithë treguesit ndërkombëtarë, Shqipëria është vendi i fundit i Ballkanit për interesin e investitorëve të huaj, sidomos për fushën e prodhimit! Kjo për shkak të kapjes së tregjeve dhe mungesës së konkurrencës. Përgjegjësi kryesor për këtë përkeqësim është Edi Rama dhe qeverisja e tij e korruptuar.

Të përsërisësh gabimet e kaluara, të bësh të njëjtën zgjedhje sot, do të thotë të dish përfundimin e 4 viteve të ardhshme: asgjë nuk do ndryshojë madje do të përkeqësohet.

Sot, Shqipëria përballët me probleme endemike të cilat pengojnë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Rreth 70% e bizneseve shqiptare ankohen se u është kërkuar rryshfet. Nga ana tjetër, korrupsioni në Shqipëri ka arritur nivelet më të larta në histori dhe është i pranishëm në të gjitha nivelet.

Si forcë e djathtë, ne jemi të bindur se varfëria luftohet dhe reduktohet vetëm përmes lirisë së tregut, mbështetjes për sipërmarrjen dhe taksave të ulta. Për këtë qëllim, ne zotohemi:

- Të fuqizojmë shtresën e mesme;
- Të vendosim taksën e sheshtë 9 %;
- Të kemi tatim mbi të ardhurat personale 9 %;
- Të kemi 9 % tatimin për biznesin;
- Të heqim fare taksat për biznesin e vogël deri në 14 milion lekë (të reja);
- Të ulim detyrimet, që bizneset e vogla paguajnë ndaj pushtetit vendor në vlerën jo më të lartë se 1 % e xhiros vjetore;
- Të aplikojmë pullën fiskale, të përjashtohen nga kontrollet tatimore bizneset e vogla, duke ofruar shërbimin ku dhe kur kërkon tatimpaguesi;
- Të vendosim kompesimin apo rimbursimin automatik nga sistemi i TVSH-së për çdo tatimpagues përfitues, duke eliminuar abuzimin, korrupsionin si dhe ndërhyrjen e administratës tatimore;
- Të bashkojmë në një institucion të vetëm tatimet dhe doganat, duke përgjysmuar burokracinë dhe duke shumëfishuar luftën kundër korrupsionit;
- Të eliminojmë Privilegjet fiskale për investitorët strategjik;
- Të heqim “taksën Rama” prej 240 lekë (të vjetra)/litër, pjesë e çmimit të karburanteve.

Me reformat strukturore, rikonceptimin e modelit ekonomik dhe luftën ndaj korrupsionit, ne synojmë një rritje ekonomike nga 5 deri në 8%.

Ne jemi të vendosur të çlirojmë tregun nga aktorët abuzive dhe klientët e korruptuar të qeverisë duke mbështetur qytetarin dhe sipërmarrësin e ndershëm.

Duke patur në thelb lirinë e tregut, taksat e ulta dhe mirëqeverisjen, ne synojmë uljen me 50% të varfërisë në fund të mandatit të parë.

Investimet e huaja

Investimet e Huaja Direkte do të jenë sa 10% e Prodhimit të Brendshëm Bruto, dhe së paku 2.5 miliard dollarë në vit. Këtë objektiv do ta arrijmë duke ndërmarrë këto reforma dhe masa:

- Do të bashkëfinancojmë me investitorët e huaj, formimin profesional të të rinjve shqiptarë në fushat e IT-së, turizmit, financës dhe në të gjitha fushat ku do të nevojitet prezenca e tyre.
- Do të bëjmë investimin më të madh për aftësimin e të rinjve duke iu ofruar atyre trajnime cilësore në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Në 4 vitet e ardhshme mbi 25.000 djem e vajza, do të trajnohen nga ekspertët më të mirë nga ShBA-ja dhe BE-ja në fushën e IT-së.

Energjia

Në fushën e energjitikës, Shqipëria ka probleme të mëdha të shkaktuara nga kjo qeveri, babëzia e saj dhe korrupsioni i tmerrshëm i Edi Ramës dhe njerëzve të tij të afërt. Është turp ta thuash, por ende sot në vitin 2025, në ato pak qendra industriale, por edhe në zonat urbane, në Shqipëri ka mungesë energjie elektrike dhe ndërprerje të dritave.

Qindra miliona euro, keqmenaxhohen sot nga buxheti për energji, për shkak të makutërisë, vjedhjes dhe abuzimeve të qeveritarëve. Shqipëria është vendi me potencialin më të madh të prodhimit të energjisë elektrike me burime natyrore, por jo vetëm, me mundësi për diversifikim të burimeve të prodhimit të energjisë së pastër nga uji, dielli, era etj. Ndërkohë, që çmimi i energjisë elektrike mbetet më i padrejti për qytetarët, për sipërmarrësit, për punishtet, biznesin e vogël, çka ndikon drejtëpërdrejtë në rritjen e kostove të prodhimit dhe çmimeve të konsumit bazë për 99% të shqiptarëve.

Ne, garantojmë se të gjithë investitorët shqiptarë e të huaj, do të kenë energji elektrike pa ndërprerje dhe të gjitha shërbimet bazë, për instalimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve të tyre.

Implementimi i plotë i reformës në sektorin e energjisë elektrike konsiston në:

- Investime të reja në burime të rinovueshme kryesisht nga dielli dhe era nga/me investitorë vendas dhe të huaj;
- Rritjen e investimeve efikase në rrjetin e shpërndarjes;
- Krijimin e tregut të përbashkët energjitik Shqipëri-Kosovë.

Infrastruktura

Qeverisja e Edi Ramës, i ka kthyer rrugët e Shqipërisë në miniera ari për miqtë e tij dhe në vatrat më të mëdha të korrupsionit qeveritar. Çmimi i ndërtimit të një kilometri rrugë në Shqipëri është i denjë për rekordet Guinness, ndërkohë që cilësia e ndërtimit të tyre është më e këqja e të gjitha kohërave.

Qytetarët e shohin përditë se edhe pasi inagurohen për fushata këto rrugë super të shtrenjta, punimet në to nuk përfundojnë kurrë. Asfalti i ri i saposhtruar gërmohet sërish, pa asnjë mbikëqyrje për të vazhduar punimet e papërfunduara apo për të bërë qokat e miqve të qeverisë.

Pas 12 viteve të qeverisjes së Ramës, rrugët e Shqipërisë janë ende të pambaruara.

Sot, ne përballemi me rrugë kombëtare të mbuluara nga mbetjet, me turistë dhe qytetarë të frustruar nga trafiku dhe smogu, me “gryka shishesh” në çdo hyrje apo dalje autostrade!

Projektet tona infrastrukturore do të përfshijnë:

- Përmirësimin e rrjetin të brendshëm të infrastrukturës kombëtare, duke ndërtuar dhe vënë në funksion korridorin Adriatiko-Jonian, pa pagesë brenda mandatit të parë qeverisës;
- Heqjen e tarifës së kalimit në rrugën e Kombit;
- Rrugë alternative veç rrugës me pagesë;
- Rehabilitimin e plotë, të aksit rrugor Shkodër-Tropojë-Kukës-Dibër-Librazhd-Përrenjas-Pogradec-Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastrë, duke e kthyer në funksion, unazën lindore kombëtare.

3.RINIA, ARSIMI, EMIGRACIONI, BRAIN GAIN, PUNËSIMI RINOR, TEKNOLOGJIA/INOVACIONI

Një vend pa rini është një vend pa të ardhme, një vend pa guxim, një vend pa fuqi transformuese. Qeveria e dështuar dhe e korruptuar e Edi Ramës kështu e do Shqipërinë, pa rini, pa guxim, pa të ardhme, sepse vetëm kështu mund të mbrojnë interesat e një pakice, që nuk ka lidhje me nevojat dhe shpresat e rinisë. Prandaj Edi Rama është përgjegjës për largimin e të rinjve shqiptarë!

Një vend ku kostot e jetesës janë të papërballueshme, forca blerëse e ulët dhe pagat larg mundësive për të ndërtuar një jetë me dinjitet, nuk është një vend për rininë.

Secili prej nesh e njeh mirë dramën e shpopullimit, nuk ka familje pa një vajzë apo djalë, që nuk ka ikur apo nuk po presin rastin e parë për të ikur nga varfëria që ka pllakosur vendin për shkak të qeverisë Rama.

Prej vitesh këmbanat e alarmit kanë rënë, por qeveria nuk dëgjon, nuk shikon, nuk e ndjen këtë plagë të madhe. Kjo do të marrë fund. Qeveria e re:

- Do të krijojë, Fondin me Prioritet për Punësimin e të rinjve në sektorin e teknologjisë, si priorite ekonomike të vendit, me synim për të rritur sipërmarrjet në fushën e teknologjisë të drejtuara nga të rinjtë.
- Do të hartojë, nisma për ta kthyer Shqipërinë në qendër të investimeve të IT-së, ku kompanitë dhe individët me mbështetjen e qeverisë, do të aftësohen që të konkurojnë në ofrimin e shërbimeve të IT-së dhe programimit në tregun e BE-së.
- Do të krijojë, grante financiare për stimulimin dhe mbështetjen e bizneseve familjare të zotëruara nga të rinjtë, që kanë në fokus zonat ku mungon përparësia ekonomike.

Me ne, qeveria e ardhshme do të financojë çdo vit, deri në 10.000 (dhjetë mijë), praktika të paguara për studentët ekselentë në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë të reja.

Nxitja dhe krijimi i ndërmarrjeve sociale nga të rinjtë duke shfrytëzuar pronat e konfiskuara të krimit nga ligji anti-mafia.

Ne, do të heqim 1000 (një mijë) euro të barrës fiskale për çdo punonjës të ri deri në 30 vjeç që ka një kontratë 3 vjeçare.

Do të ulim taksën e fitimit për 3 vitet e para të veprimtarisë të të gjithë investitorëve në fushën e IT-së, Mekanik dhe Elektronik, të cilët punësojnë të rinj deri në 30 vjeç.

Do të bëjmë subvencionim të pagës së plotë ose të pjesshme që marrin jashtë vendit, për 1 (një) vit, për çdo profesionist të ri ekselent nëse vendos të Ri-kthehet në Shqipëri.

RINIA MERITON MË SHUMË!

Ne e kemi gati projektin më të madh dhe transformues, i cili do të ndryshojë totalisht ekonominë shqiptare duke çelur një horizont të ri për të rinjtë tanë.

Në bashkëpunim me Universitetet:

- Ne, do të ndërtojmë 4 qendra Rajonale të Inovacionit, më të mëdhatë në Ballkan: në Tiranë, në Shqipërinë e mesme, në Jug dhe në Veri;
- Ne, do të përgatisim 25.000 profesionistë të rinj në profesionet e teknologjisë që kanë një pagë mesatare prej 2000 Euro në muaj;
- Ne, do të mbështesim zhvillimin e Ekonomisë Digjitale, do ta kthejmë Shqipërinë në një qendër të investimeve në Teknologji, ku kompanitë dhe individët me mbështetjen e qeverisë, do të aftësohen që të konkurojnë në tregun global.

Vizioni ynë për *Gjeneratën e Re* përbëhet nga këto projekte kyçe, me fokus zhvillimin e Inteligjencës Artificiale:

Së pari, ne do të krijojmë fondin “NEXT GEN” për të subvencionuar pagën e plotë ose të pjesshme, të çdo profesionisti të ri që vendos të kthehet në Shqipëri. Ky fond do të mbulojë pagën e tyre për një vit, duke i dhënë mundësi profesionistëve të kualifikuar dhe me eksperiencë jashtë vendit, të kontribuojnë në zhvillimin e Shqipërisë.

Së dyti, do të ngrejmë “Fondin e Inovacionit”, të dedikuar për sektorin e Inteligjencës Artificiale.

Së treti, do të themelojmë “Cybersecurity Innovation Hub”. Kjo qendër inovacioni do të përfshijë universitete, sipërmarrje të reja, profesionistë të lirë dhe të rinj të moshave të ndryshme, në një mjedis ku kërkimi shkencor, zhvillimi dhe inovacioni në fushën e sigurisë kibernetike mund të përparojë.

Arsimi Parauniversitar dhe ai Profesional

Arsimi Parauniversitar dhe ai Profesional, sot është në ditët më të këqija. Shkolla të rrënuara, pa kushte të përshtashme. Mësuesit janë të pamotivuar dhe pa një status të merituar për rolin e tyre udhëheqës në edukimin dhe formimin e brezave të rinj, që do të jenë e ardhmja e shoqërisë dhe kombit tonë.

Pothuajse 50% e shkollave në Shqipëri nuk kanë ujë të pijshëm dhe rreth 70% e shkollave nuk kanë kushte të përshtatshme higjienike. (Raporti i UNESCO-s).

Raportet tregojnë se 41% e nxënësve shqiptarë janë viktimë të dhunës fizike dhe psikologjike, ndërsa 22% e tyre ndihen të kërcënuar nga mësuesit (raporti i UNESCO-s).

Ne, kemi një vizion të qartë në shndërrimin e shkollave si institucione arsimore për nxitjen e mendimit krijues dhe kritik, qendra edukimi që ndihmojnë në ZHVILLIMIN E AFTËSIVE DHE TALENTEVE INDIVIDUALE dhe vatra të mirëqënies dhe sigurisë së nxënësve.

Programi ynë ofron:

- DYFISHIMIN E BUXHETIT PËR ARSIMIN nga 3.5-3.7% të PBB-së vetëm për arsimin parauniversitar;
- Rritje 60% të pagave të mësuesve duke sjellë më shumë të ardhura e mirëqenie për 30 mijë familje të mësuesve.

Risia për gjithë arsimin parauniversitar dhe për prindërit, do të jetë shkolla gjatë gjithë ditës me drekë të garantuar për të gjithë nxënësit.

Në këtë koncept shkolla do të qëndrojë e hapur prej orës 8.00-16.00. Pas orarit të mësimit, nxënësve do t'u ofrohet mundësia për përvetësimin e dijeve, mësimin e gjuhëve të huaja dhe të aftësimit në TIK si dhe veprimtari kulturore dhe artistike. Për këtë qëllim do të angazhohen dhe punësohen 7500 specialistë të fushave të mësipërme.

Ne do të sigurojmë:

- Transport të dedikuar e të standardizuar me parametra bashkëkohore, për çdo mësues e nxënë, në arsimin parauniversitar që banon mbi 3 km larg shkollës.
- Tekste të reja, falas, në arsimin e detyruar (klasat 1-9), çanta dhe mjete didaktike për fëmijët në vështirësi ekonomike.
- Kurrikula të përmirësuara, në përshtatje të plotë me zhvillimin dhe nevojat e nxënësve si dhe kërkesave të shoqërisë.

Universitetet

Gjatë qeverisjes së tij, i vetmi kontribut që ka dhënë Edi Rama është shndërrimi i Shqipërisë në vendin e parë në botë të eksportuesit të qytetarëve të tij. Kushdo e ka të qartë se me këtë model qeverisës, ky vend nuk ka kurrfarë perspektive, ndaj zgjedhin të largohen.

Kostoja e jetesës është shumë e lartë, ndërsa pagat shumë të ulëta. Nënata qajnë për fëmijët që largohen përditë nga vendi, ndërsa Edi Rama mburret me projekte 3D në rrjetet sociale. Varfëria rritet përditë dhe të gjitha këto probleme, kanë një emër të përbashkët: Edi Ramën dhe qeverisjen e tij të dështuar.

Ndaj program ynë do të bëjë të mundur që:

- Në ditët e para të Qeverisë së saj, të nisë punën për rikonceptimin e Ligjit të Arsimit të Lartë, në bashkëpunim me botën akademike, ekspertët më të mirë dhe studentët shqiptarë;
- Të bëjmë transparencë të plotë në procesin e akreditimit nga agjencitë ndërkombëtare të rankimit të universiteteve dhe të programeve të studimit;
- Të bëjmë regjistrimin e pronave të universiteteve dhe kalimin në pronësi të tyre, duke garantuar me ligj vetadministrimin e këtyre pronave;
- Të krijojmë Bibliotekën Ndër-universitare Kombëtare Online;

- Të rrisim rolin e studentëve në zgjedhjet universitare, vlera e votës së të cilëve shkon deri në 30%;
- Të dyfishojmë buxhetin për Arsimin e Lartë;
- Të ndërtojmë brenda mandatit të parë 3 kampuse universitare: në Tiranë, Elbasan dhe Shkodër;
- Të financojmë praktikën njëvjeçare pas studimeve për 10 mijë studentë, duke garantuar kështu lidhjen e tyre me tregun;
- Të financojmë bursa për studentët dhe doktorantët ekselentë në 15 universitetet më të mira në botë, si dhe promovimin e programit për thithjen e trurit, larg nepotizmit dhe ndërhyrjes politike, por bazuar në meritokraci. *“From: brain drain, to brain gain”*.
- Të shpallim programet universitare të mësuesisë si “Prioritet kombëtar”, duke nxitur të rinjtë të studiojnë në këtë fushë me rëndësi për ardhmërinë e vendit, përmes politikave mbështetëse të arsimimit, punësimit, dhe sigurisë financiare;
- Të japim autonomi të tillë universitete shqiptare, që përmes parimit meritë-preferencë, të kenë mundësi të bëjnë vetë përzgjedhjen e studentëve të tyre.
- Të depolitizojmë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të organizimit dhe funksionimit të saj;
- Të krijojmë Fondin Shqiptar për Shkencë, Inovacion dhe Zhvillim, ku të konkurrojnë të gjithë IAL (Institucionet e Arsimit të Lartë) publike dhe jo vetëm, institutet kërkimore, hulumtues shkencorë, bazuar në meritokraci;
- Të ngrejmë Universitetin e Diasporës: përmes krijimit të një databaze të kërkuesve shkencorë, doktorë shkencash dhe profesorë shqiptarë, për të kontribuar në edukimin dhe aftësimin universitar në Shqipëri, në bashkëpunim me universitetet publike, përmes një fondi të dedikuar për financimin e aktiviteteve.

4. FAMILJA DHE GRUAJA: POLITIKAT SOCIALE SI PENSIONET, NDIHMA SOCIALE, PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR (PAK)

Në një kohë kur qeveria e Edi Ramës është e zhytur në skandale dhe është mbytur nga zullumet, ne jemi forca e parë politike që ka gati një program për familjet shqiptare dhe një plan konkret për daljen nga kriza. Ne e dimë që Shqipëria po shkon përditë dhe më shumë në drejtimin e gabuar! Familjet shqiptare po përjetojnë ditët më të vështira mes varfërisë që rritet, emigracionit që e gërryen dhe pasigurisë për të ardhmen e rinisë!

Në qeverisjen e re, ne do të garantojmë:

- 5 milion euro do të jetë granti për ngritjen e 1000 bizneseve të reja vetëm për gratë sipërmarrëse;
- Personat me aftësi të kufizuar do të jenë pjesë reale e vendimarrjeve tona qeverisëse si dhe do t'iu subvencionohen shërbimet sipas nevojave të tyre;
- Pagesa për personat me aftësi të kufizuar do jetë 70% e pagës minimale;
- Ndryshimin e statusit të jetimit, duke zgjeruar numrin e përfituesve, përfshirë edhe ata që nuk kanë njërin prind.

Emigracioni, pasiguria për të krijuar familje të reja, ulja e lindshmërisë dhe kostot e larta të strehimit, i pamundësojnë familjeve të reja të ndërtojnë një të ardhme në vendin e tyre.

Prandaj ne:

- Do të subvencionojmë interesin e plotë të kredisë për strehim për 30 000 (tridhjetë mijë) çifte të reja;
- Do të mundësojmë pagë të plotë për periudhën e lejes së lindjes për nënat në marrëdhënie pune;
- Do të dyfishojmë ndihmën ekonomike;
- Do të mundësojmë orientimin e vajzave dhe grave për të ndjekur studime apo kryer kurse profesionale, në fushat e lidhura me teknologjinë e informacionit, nëpërmjet programit “Gratë në digjitalizim”;
- Do të rrisim pagat dhe do të mundësojmë taksim të diferencuar dhe mbështetje të arsimit profesional, për të përmirësuar ekuilibrin gjinor në profesionet, të cilat janë mbizotëruar tradicionalisht nga burrat;
- Do të ofrojmë mbështetje financiare për gra dhe vajza që kontribuojnë në industrinë e artizanatit.

Familja

Sot në Shqipëri ekzistojnë dy botë: bota e Ramës, që jeton në spektaklin që krijon vetë dhe në realitetin që shpik vetë; dhe bota e familjeve shqiptare, që përjeton çdo ditë uljen e mirëqenies, shtrenjtimin e jetesës dhe braktisjen nga qeveria.

Ne jemi e vetmja forcë politike, në fund të kësaj klase politike të vjetër 35-vjeçare, që ka një plan që prek në zemër hallet e familjeve shqiptare.

Për ne, një shtyllë solide e programit tonë qeverisës është çështja e familjes, e fëmijëve dhe e pensionistëve shqiptarë.

Për familjet e reja, që janë qeliza dhe garancia e vetme jo thjesht e vijimësisë së familjes, por edhe e vijimësisë sonë kombëtare:

- Do të ketë një ndihmë prej **2 milion lekësh** për fëmijën e parë dhe për fëmijën e dytë
- Për fëmijën e tretë, kjo shifër do të **dhjetëfishohet**, duke arritur në **20 milion lekë**;
- Kjo mbështetje ofrohet për herë të parë në Shqipëri dhe do të jetë pika e kthesës në përtëritjen tonë kombëtare;
- Pensionet do të rriten të paktën 5% në vit;
- Pensionet do të indeksohen me dyfishin e vlerës së inflacionit çdo vit;
- Për pensionet e ulëta – ato të bukës së gojës dhe ilaçeve – do të ketë një **bonus të përhershëm, periodik prej 250 mijë lekësh**;
- Skema e pensioneve do të forcohet, duke rritur deklaratimet e sakta të pagave dhe numrin e të punësuarve.

Gruaja është prioriti ynë!

Që gruaja shqiptare të rimarrë rolin që i takon në shoqëri, për të qenë e pavarur, për të marrë dinjitetin dhe fuqizimin e saj ekonomik, kjo mund të arrihet nëpërmjet mirëarsimit. Programi ynë qeverisës angazhohet që:

- Asnjë vajzë të mos ndërpresë shkollën për shkak të pamundësive ekonomike;
- Të japim bursa studimi për vajzat që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike dhe nga zonat rurale;
- Të japim mbështetje financiare për gra dhe vajza që merren me punë artizanale dhe që punojnë në sektorin e bujqësisë;
- Të japim kurse falas për gratë e vajzat shtëpiake që të marrin një profesion;
- Të shtojmë burimet financiare në funksion të programeve për mbrojtjen e shëndetit të gruas;
- Të dyfishojmë ndihmën ekonomike për gratë kryefamiljare, viktimat të dhunës;
- Të japim bursa studimi falas për të gjithë fëmijët e nënave kryefamiljare, viktimat të dhunës në familje;
- Të japim strehim të paguar nga shteti për të gjitha gratë, të cilat kanë marrë urdhër mbrojtjeje nga gjykatat.

5.SHËNDETËSIA

Premtoi një shëndetësi falas, por në fakt shtrenjtoi gjithçka dhe ndërtoi një piramidë korruptive në të gjithë sistemin shëndetësor: ky është Edi Rama dhe koncepti i tij për shëndetësinë.

Sistemi shëndetësor sot gjendet në një situatë të vështirë, i keqmenaxhuar nga një administratë joefektive, e drejtuar nga persona që spitalet apo qendrat shëndetësore i kanë parë vetëm si pacientë ose vizitorë.

Programi ynë “Shqipëria meriton më shumë” ofron:

- Ristrukturimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve sociale - sistemi shëndetësor do të jetë në duar të specialistëve;
- Mbrojtja sociale do të bëhet një institucion më vete;
- Rishikim i rolit të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;
- Rritja dhe forcimi i autonomisë financiare dhe menaxheriale të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshëm Shëndetësor;
- Ristrukturimi i Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) sipas modelit ECDC (Qendra Evropiane për Kontrollin e Sëmundjeve);
- Investim në burime njerëzore, infrastrukturë, pajisje dhe laboratore sipas standardeve evropiane;
- Rritja të kapaciteteve dhe rezervave për përballimin e situatave epidemike (afatgjatë);
- Forcim të programeve të promocionit shëndetësor;
- Krijim të regjistrit kombëtar të sëmundjeve jo të transmetueshme.

Financimi i sistemit shëndetësor

Sot, sistemi shëndetësor shqiptar është më i keqfinancuari në rajon, ku askush nuk paguan sa shqiptarët për shëndetin. Shqiptarët paguajnë më shumë sesa të gjithë qytetarët e rajonit tonë, katër herë më shumë se mesatarja e vendeve të BE-së, dhe ndërkohë marrin shërbimin më të keq.

Politikat e ndjekura në farmaceutikë sollën largimin e përfaqësive farmaceutike dhe kompanive prestigjioze, duke hapur rrugën e barnave me origjinë të pasigurtë dhe cilësi të ulët, si dhe uljen e numrit të alternativave.

Ndaj, ne angazhohemi të rikonceptojmë skemën e sigurimeve shëndetësore dhe modelin e financimit, si dhe të reformojmë sektorin farmaceutik, si më poshtë:

- Forcim të skemës së sigurimeve shëndetësore. Kalimi nga një pagues i vetëm në disa pagues;
- Rritje të buxhetit për shëndetësinë, me 50% fondin e rimbursimit dhe fondin e pagave: motivim të personelit që punon me dinjitet, si dhe uljen e numrit të mjekëve që largohen nga vendi;
- Anullim të PPP-ve të panevojshme që zhvasin 53 milion euro përmes katër koncesioneve;
- Zbatim të parimit “para do të ndjekë pacientin” – Çdo shqiptar do të ketë në dorë kartën e sigurimit shëndetësor, përmes të cilës mund të shkojë të vizitohet ku të dojë, në shërbim publik apo privat, dhe nuk do të ketë nevojë të paguajë nga xhepi;

- Krijimi i Agjensisë Kombëtare të Llogarive Shëndetësore, si mekanizëm kontrolli për çdo shpenzim, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat;
- Investim në teknologjinë digjitale – në mbështetje të mënyrës së re të jetesës dhe realitetit të punës në sistemin shëndetësor. Kartela elektronike, si mundësi për pacientin që të vizitohet ku të dëshirojë dhe të mbartë me vete, historikun e tij shëndetësor;
- Përmirësim të paketës bazë të sigurimeve shëndetësore – rimbursim bazuar në diagnozë;
- Luftë ndaj barnave jo cilësore, luftë mafies së barnave, bllokim i barnave nga vendi i origjinës jo të sigurtë.

Shqiptarët nuk do të paguajnë më ‘qimet e kokës’, për barna që nuk i kurojnë.

Kujdesi spitalor

Infrastruktura e shërbimit shëndetësor në Spitalet Bashkiake, Rajonale dhe ato Universitare si QSUT dhe Spitali i Traumës, gjenden në një situatë mjaft të vështirë funksionale për të ofruar shërbim mjekësor dinjitoz.

Koalicioni Euroatlantik ka si qëllim dhe detyrim rivitalizimin e sistemit shëndetësor që popullata të marrë shërbim me standard mjekësor dinjitoz.

- Rikonceptim i menaxhimit spitalor, sipas modelit “spitali ndërmarrje” me autonomi të menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore;
- Financim i spitaleve, bazuar në performancë (DRG), që motivon cilësinë e shërbimit;
- Shërbim urgjence paraspitalore dhe spitalore, sipas standardeve më të mira evropiane, duke ofruar shërbim, ndërhyrje mjekësore reale që në vendngjarje, gjatë transportit dhe deri në pranim të sëmurit në urgjencën spitalore.
- Rritje me 50% të pagave të mjekëve, farmacistëve, infermierëve dhe teknikienëve mjekësorë brenda mandatit të parë qeverisës;
- Rritje dy herë e kuotave të pranimit të mjekëve në Fakultetin e Mjekësisë, dhe në specializime;
- Krijimin e Institutit të Onkologjisë si entitet i pavarur.

Kujdesi shëndetësor parësor

Mjekët e familjes dhe infermierët, janë kthyer në argatë të kompanisë së check-up, madje atyre iu vendosin gjobë nëse nuk plotësojnë planin.

Personeli është i keqpaguar, sepse qeveria socialiste lekët e pagave dhe shpërblimeve ia jep koncesioneve korruptive të miqve të saj.

Në këto kushte programi ynë ka si qëllim:

- Qendra shëndetësore të vetmenaxhuara;
- Forcim të kujdesit shëndetësor parësor bazuar në parimin: *vendosim në qendër pacientin jo sëmundjen*;

- Rritja të pagave me 50%. Mjekët dhe infermierët shqiptarë do të kenë pagat më të larta në Ballkanin Perëndimor;
- Heqjen e punës së detyruar 3 vjeçare të mjekëve të rinj, duke krijuar kushte pune miqësore dhe motivuese.

6 ZHVILLIMI RURAL/ FERMERËT / BUJQËSIA

Traktati i Romës i 1958-ës e vendosi bujqësinë në zemrën e veprimtarive të Bashkimit Ekonomik Evropian, me objektiv rritjen e prodhimit, një standard të drejtë jetese të familjes fermere!

Sot, vendi ynë, gjendet përpara një situatë kur bujqësia shqiptare po lëngon e braktisur dhe ku po bëhet nevojë urgjente ringjallja e saj.

Për ne, bujqësia deklarohet misioni i qeverisë së re, sepse pa bujqësi nuk ka zhvillim rural, nuk ka turizëm, nuk ka mirëqenie urbane, nuk ka emancipim shoqëror, nuk ka demokraci.

Subvencionet dhe përkrahja për fermerët:

- 100 milion euro subvencione në bujqësi që në vitin e parë të qeverisjes;
- Thjeshtimi i procedurave dhe eliminimi i kufizimeve për fermerët;
- Çdo vit, mbi 150 mijë fermerë do të përfitojnë fonde për farëra, fidane, plehra kimike, pesticide dhe kafshë race, duke ulur me 30-40% kostot e prodhimit.

Mbështetje për sektorët kyç:

- Përkrahje për aktivitetet e agroturizmit dhe promovimin e produkteve lokale;
- Lehtësi për kreditë e fermerëve dhe agro-përpunuesve për teknologji të reja;
- Pagesa deri në 50% të primit të sigurimit të prodhimeve bujqësore ndaj fatkeqësive natyrore.

Objektiva strategjike:

- Rritje trefish e eksporteve bujqësore brenda katër viteve, duke tejkaluar vlerën e importeve;
- Rehabilitim të infrastrukturës në zonat rurale;
- Ndërtim të tregjeve moderne në të gjitha bashkitë, me të gjithë standardet për ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

Me qëllim që të arrihet një rritje ekonomike e qëndrueshme, me jo më pak se 5-8 % në vit, ky sektor do të mbështetet me një buxhet dy herë më të madh se sa buxheti aktual.

- Do të synohet, që brenda katër viteve të qeverisjes së re, eksportet bujqësore të rriten 3 herë në vlerë, duke kalur vlerën e importeve;
- Financimi, do të shkojë drejtpërsëdrejti atje ku punohet dhe prodhohet;
- Rehabilitim të infrastrukturës, vaditje, drenim, kullim dhe masa kundër përmytjeve;
- Subvencion në pikat kyçe që i shërbejnë fermerit, sipas avantazheve të krahasuara, të gjithë komunitetit dhe tregut;
- Program për 'Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural' duke garantuar një përafrim gradual të mëtejshëm, në prodhim, në përpunim dhe standarde në përputhje me Politikën e Përbashkët Bujqësore Evropiane.

Siguria Ushqimore

Siguria ushqimore është thelbësore për mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik në Shqipëri. Programi ynë qeverisës, synon të krijojë një sistem të plotë të sigurisë ushqimore përmes masave rregullatore, edukimit, monitorimit dhe zbatimit.

- Agjencia Kombëtare e Ushqimit (AKU) do të fuqizohet për të mbikqyrur rregulloret e sigurisë ushqimore, inspektimet dhe zbatimin. Do të krijohet koordinimi midis Ministrive-asaj të Bujqësisë, Shëndetësisë dhe Mjedisit-, për një qasje të unifikuar ndaj sigurisë ushqimore, e cila është e munguar deri më tani. Rritja e investimeve për krijimin e një infrastrukture moderne laboratorike sikurse reformimi i rrjetit të laboratorëve rajonal do ketë vëmendjen e merituar.
- Do të konsolidohen kapacitetet e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) si institucioni publik përgjegjës i referencës në nivel qendror dhe rajonal.
- Do të zhvillohet një sistem gjurmueshmërie që monitoron produktet ushqimore nga ferma në pjatë, duke siguruar përgjigje të shpejta ndaj incidenteve të sigurisë ushqimore.
- Prioritet do t'i kushtohet produkteve me origjinë shtazore për plotësimin e standardeve të BE-së dhe çertifikimin e tyre për të rihapur eksportet.
- Në raftet e shitoreve nuk do të ketë më, produkte të formuluar në bodrume. Zero tolerancë ndaj informalitetit, po njësoj ndaj monopoleve që kurojnë vetëm interesin individual dhe jo atë kombëtar.
- Do të fuqizohet, bashkëpunimi ndërkombëtar duke kërkuar ndihmë teknike, ekspertizë dhe burime nga programet e BE-së të dedikuara për sigurinë ushqimore duke bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare si: Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) etj.
- Do të zhvillohen metrika të performancës për të matur efektivitetin e programit të sigurisë ushqimore.

7 TURIZMI / MBROJTJA E AMBJENTIT / PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ZHVILLIMI I TERRITORIT

Turizmi

Vizioni ynë për diversifikimin e ofertës turistike të Shqipërisë, duke mundësuar turizmin përgjatë katër stinëve.

Objektivat Kryesorë të programit për zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm bazohen tek:

- Zhvillimi i qëndrueshëm – Promovimi i turizmit që ruan diversitetin kulturor, traditat lokale dhe trashëgiminë natyrore e kulturore.
- Përdorimi i integruar i tokës – Plane gjithëpërfshirëse që përshtaten me karakteristikat kulturore dhe mjedisore të rajoneve.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – Mbrojtja e vendeve historike, artefakteve dhe traditave përmes konservimit dhe edukimit.
- Mbrojtja e mjedisit – Masa për reduktimin e ndikimit turistik dhe urban, ruajtjen e biodiversitetit dhe përballjen me ndryshimet klimatike.
- Inovacioni dhe teknologjia – Përdorimi i industrisë kreative dhe teknologjisë për menaxhimin transparent dhe efikas të turizmit.

Reforma për të zhvilluar sektorin e turizmit, si sektor të qëndrueshëm synohet të arrihet nëpërmjet:

Përmirësimi i klimës së biznesit në turizëm

- Lehtësime në lëshimin e lejeve të ndërtimit për akomodimet turistike;
- Heqjen e qasjes selektive lidhur me stimujt tatimorë dhe futjen e masave horizontale;
- Zbutjen e rregullave të certifikimit dhe liçencimit për aktivitetet e lidhura me turizmin, duke i hequr këto kërkesa ose duke i lehtësuar ato;
- Zhvillimin e skemave efikase dhe garanci të transparencës për tërheqjen e Investimeve e Huaja Direkte në turizëm.

Shfrytëzimi efektiv i potencialit të jashtëzakonshëm turistik të Shqipërisë

- Ngritja e shkollave të mirëfillta turistike;
- Zhvillimi i Turizmit Blu (Plazh/Tokë/Ujë) dhe lidhja e tij me turizmin e ushqimit, të natyrës dhe të kulturës, të orientuar drejt zonave malore;
- Zhvillimi i turizmit MICE (Meeting, Incentives, Conferences, Exhibitions) dhe *brandimi*;
- Zhvillimi i targetuar i vendeve të reja turistike;
- Promovim i orientuar dhe promovim efektiv përmes fushatave reklamuese ndërkombëtare
- Eksplorimi i mundësive për turizmin rajonal dhe katër-stinor.

Përmirësimi i infrastrukturës së transportit

- Rritja e investimeve në infrastrukturën turistike dhe tërheqja e kapitalit privat në modernizimin e infrastrukturës;
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese të aeroportit dhe porteve për të përballuar fluksin në rritje të turistëve;

- Zgjerimi i gjeografisë së marrëveshjeve të qiellit të hapur, duke përfshirë vendet e Azisë.

Turizmi si prioritet kombëtar.

- Sipas modeleve më të përparuara rajonale, ne do të subvencionojmë fuqinë punëtore në sektorin e turizmit gjatë periudhës jashtë sezonit, për të garantuar të ardhura të qëndrueshme për punonjësit dhe familjet e tyre;
- Do të hapim katër shkolla profesionale me fokus turizmin, për të përgatitur profesionistë të kualifikuar në këto qytete: Korçë, Shkodër, Berat, Gjirokastrë;
- Do të përmirësojmë rrjetin e brendshëm të infrastrukturës kombëtare, duke ndërtuar dhe vënë në funksion korridorin Adriatiko-Jonian pa pagesë brenda mandatit të parë qeverisës;
- Do të heqim tarifën e kalimit në rrugën e Kombit;
- Asnjë rrugë nuk do të jetë me pagesë pa pasur rrugë alternative.

Infrastruktura

Ne përballemi me zona turistike të mbytura nga mbetjet; përballemi me turistë të frustruar nga trafiku dhe smogu; përballemi me zona turistike që nuk kanë shërbimet bazë infrastrukturore, si energjia elektrike apo uji i pijshëm; përballemi me turistë të pashërbyer dhe në rastin më të keq përballemi me zona turistike të pasigurta.

Për të gjallëruar turizmin katër-stinor, ne do të rehabilitojmë aksin rrugor Shkodër-Tropojë-Kukës-Dibër-Librazhd-Përrenjas-Pogradec-Korçë-Ersekë-Leskovic-Përmet-Gjirokastrë duke kthyer në funksion unazën lindore kombëtare.

MJEDISI

Në nivel qeverisjeje qendrore, ne do ta ndajmë mjedisin nga turizmi. Për këtë qëllim, menaxhimi politik administrativ i mjedisit, do të jetë një fushë më vete.

Në qeverisjen e re, ne do të krijojmë **Fondin e Mjedisit**, ku çdo e ardhur nga taksimi mbi pasojat mjedisore do të destinohet direkt për eliminimin e asaj pasoje, siç është aktualisht p.sh. *taksa mbi ndotjen*, që shkakton çdo litër karburant.

Pra, Fondi Mjedisor do të jetë një rrjedhje transparente, lehtësisht e identifikueshme e çdo qindarke: nga burimi i të ardhurave e deri tek përdorimi në mjedis.

Ne do të bëjmë transparencën e menjëhershme të skandalit të inceneratorëve, si njollë turpi në sektorin e mjedisit në Shqipëri, i cili e ka kthyer menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri më mbrapa nivelit të vitit 2011.

Ne do të rivendosim në binarë ligjorë, menaxhimin e mbetjeve, në përputhje me parimet e Bashkimit Evropian, Legjislacionin dhe Strategjinë Kombëtare.

Prioritet do të ketë përfshirja e komuniteteve në zgjidhjet e qëndrueshme, me bazë procesin **reduktim-ripërdorim-riciklim**.

Ne do të vendosim partneritet me ricikluesit vendas për *Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve*, një partneritet parimor dhe ekonomik.

Do të kryejmë ristrukturimin dhe rritjen e kapaciteteve të Agjencive Kombëtare (Mjedisit, Zonave të Mbrojtura, Bregdetit, Burimeve Natyrore dhe Administrimit të Mbetjeve dhe Ujërave) si edhe të Inspektoriatit të Mjedisit, për t'iu përgjigjur nevojave të reja të integritetit në BE.

Do të vendosim standardet e Bashkimit Evropian për përdorimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore dhe gjuetinë e kontrolluar dhe do t'i japim fund hipokrizisë dhe gënjeshtërisë së abuzimit në këta dy sektorë.

Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i territorit

VIZIONI

Një Shqipëri e zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme, ku planifikimi i territorit, ruajtja e trashëgimisë kulturore, mbrojtja e mjedisit dhe inovacioni kombinohen për të krijuar një shoqëri dinamike, rezistente dhe gjithëpërfshirëse.

STRATEGJIA

Strategjia për planifikimin, menaxhimin dhe zhvillimin e territorit bazohet në një model të planifikimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të territorit, duke u mbështetur te prona private, liria e sipërmarrjes, zhvillimi ekonomik i balancuar dhe ruajtja e vlerave kulturore e mjedisore. Qasja është ndërsektoriale dhe integruese, duke ndërlidhur planifikimin urban, turizmin, bujqësinë dhe transportin me teknologjinë dhe inovacionin.

Planifikimi i Qëndrueshëm dhe Rezilient i Territorit nëpërmjet Urbanizimi të balancuar, me akses të barabartë në punë, strehim, arsim dhe shërbime publike. Një zhvillim i balancuar urban synon akses të barabartë në punësim, strehim, arsim dhe shërbime publike, duke siguruar rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të cilësisë së jetës.

Decentralizimi i vendimmarrjes dhe përfshirja e aktorëve të shoqërisë në proceset e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Decentralizimi i vendimmarrjes dhe përfshirja e aktorëve shoqërorë garanton një planifikim gjithëpërfshirës dhe efektiv të territorit, duke rritur pjesëmarrjen dhe përgjegjëshmërinë

Progresi ekonomik i vendit nëpërmjet rritjes së turizmit, duke synuar konservimin e pasurive natyrore dhe vlerësimin e atyre kulturore është baza e zhvillimit të qëndrueshëm që programi për planifikimin e territorit synon.

Zhvillimi ekonomik dhe qëndrueshmëria sociale si edhe adresimi i ndryshimeve demografike si pasojë e pasigurisë dhe paqëndrueshmërisë ekonomike të vendit dekadën e fundit, do të bëhet i mundur nëpërmjet stimulimit të zhvillimit kapilar, maksimalizimit të performancës së tokës në pronësi private dhe ndërmarrjeve që janë të orientuara rreth familjeve, me fokus të veçantë në industrinë e turizmit dhe bujqësisë.

Ne besojmë, se ky progres mund të arrihet përmes përdorimit të inovacionit dhe teknologjisë, me fokus pronën private dhe iniciativën e lirë, ku turizmi do të jetë forca nxitëse e zhvillimit ekonomik të familjeve shqiptare.

Përdorimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në rritjen e transparencës në vendimmarrje. Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe garantimi i transparencës në vendimmarrje do të ndihmojë në optimizimin e politikave zhvillimore dhe eliminimin e praktikave abuzive.

Një dimension thelbësor i vizionit tonë është **zhvillimi i koridoreve kulturore-historike** në funksion të zhvillimit të turizmit anë e kënd vendit, ku kultura dhe trashëgimia kulturore në veçanti, si pilari i katërt i zhvillimit të qëndrueshëm, ka të mbërthyer dhe të paeksploruar potenciale të jashtëzakonshme jo vetëm turistike.

Ne do të nxisim zhvillimin ekonomik ndërkufitar në sektorë si: turizmi, bujqësia, blegtoria, energjia dhe menaxhimi i ujërave. Kjo qasje “përtej kufijve” do të përmirësojë jo vetëm shkëmbimet tregtare dhe kulturore midis shteteve fqinje, por do të kontribuojë edhe në kohezionin social të bashkëjetesës dhe ndërveprimit mbarëshqiptar.

Planifikimi i fokusuar tek rajonet si një qasje ndër-administrative, integron bashkëjetesën dhe bashkëpunimin e komuniteteve nga njëra anë, dhe nga ana tjetër eviton segmentimin e investimit, minimizon vendimet arbitrare në zhvillime pikësore, të izoluara dhe preferenciale.

Nxitja dhe promovimi i produkteve tradicionale shqiptare përmes një plani ndërsektorial gjithëpërfshirës, ka për qëllim rikthimin e traditave më të mira vendase, në kulturat bujqësore e blegtorale; zejtarinë dhe kulinarinë e larmishme, si pjesë e pandashme e përvojës turistike. Që këto nisma të jenë të qëndrueshme në kohë kërkojnë përforsimin e iniciativave të zhvillimit të pronës private.

Zhvillimi i koridoreve kulturore-historike kryq e tërthor vendit. Orientimi i turizmit si sektor i ri i ekonomisë në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë familjar të lidhur me pronën dhe iniciativën. Nxitja dhe mbështetja e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në rajonet e mesme dhe të larta me orientim zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm. Promovimi i turizmit të lëvizshëm dhe atij miqësor me mjedisin në ujë dhe tokë (det, mal, liqen, kodër, lumë)

Integrimi i trashëgimisë kulturore në planet e zhvillimit të territorit, ul rrezikun e izolimit dhe shkatërrimit të saj, dhe balancon zhvillimin duke vendosur një ekuilibër midis përfitimeve ekonomike dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Ruajtja dhe valorizimi Zhvillimi urban pa kriter dhe pa kontroll ka çuar në shpërbërjen e hapësirave të mbrojtura, historike dhe kulturore, atyre të gjelbërta duke rritur ndotjen e ajrit, ujit dhe të tokës. Planifikimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm për të zbutur ndikimin mjedisor të aktiviteteve njerëzore, për të ruajtur biodiversitetin dhe për të luftuar ndryshimet klimatike nëpërmjet praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve, është në objektivat e vendosur për tu adresuar nga planifikimi i territorit.

Edukimi, Bashkëpunimi dhe Kontributi Shoqëror në Turizëm të qëndrueshëm nëpërmjet trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve për stafin dhe bizneset e turizmit, përfshirjes së komunitetit lokal në menaxhimin e zonave, ruajtjen e traditës dhe ekuilibrave mjedisorë, si edhe angazhimit të aktorëve të tjerë sociale si universitete, OJQ, institucionet, në monitorimin dhe planifikimin e qëndrueshëm të turizmit.

Është pikërisht kjo qasje holistike, e cila është garanci për ruajtjen e mjedisit natyror, sistem i cili ka potencialin e madh të përbashkojë dhe zhvillojë ura bashkëpunimi dhe bashkëjetese midis brezave të shoqërisë.

8. REFORMA E PRONËS DHE TË PERNDJEKURIT POLITIKË

PRONA ËSHTË E SHENJTË

Shqipëria është i vetmi vend i cili nuk ka zgjidhur problemin e pronës. Kush është fajtor për këtë? Sigurisht në majë të gjuhës kemi kundërshtarin tonë politik, padiskutim që është ai fajtor. Por, fajtori më i madh për zgjidhjen e problemit të pronës është edhe Partia Demokratike. Kjo parti duhet të marrë përgjegjësinë historike për moszgjidhjen, madje për katranosjen edhe më tej të problemit të pronës, duke filluar me ndjesën më të thellë ndaj çdo pronari. Por ndjesa nuk mjafton.

Ne si forcë e djathtë besojmë tek prona dhe tek shenjtëria e saj. Mbi të gjitha, ne besojmë se mbi 80% e pronarëve shqiptarë, që sot nuk kanë letrat e pronave të tyre në dorë, janë zinxhiri më i rëndë, në qafën e ekonomisë së Shqipërisë.

Imagjinoni një pronar që sot i thonë ish-pronar që nuk ia kthejnë pronën, megjithëse është e lirë.

Imagjinoni dikë tjetër që ia kanë zënë pronën dhe i thonë se do ta kompensojmë me 3, 4, apo 5% të vlerës së tregut.

Ndërkohë, që edhe ai që ia ka zënë pronën po kështu vërtitet sa tek legalizimet, tek drejtoritë e titujve të pronës së 7501-it.

80 në 100 shqiptarë nuk kanë letrat e pronës. Nuk jemi në mesjetë, jemi më keq.

Ky është një problem që shoqëritë moderne e kanë zgjidhur prej 600 vjetësh, e në Shqipëri vazhdon të peshojë në bilancin e ekonomisë kombëtare dhe në bilancin e ekonomive familjare.

Nuk ka reformë më të rëndësishme për Shqipërinë evropiane, se ta zgjidhim një herë e mirë, pasigurinë e pronës dhe të kthejmë në një mënyrë ose në një tjetër, 100%, pronën tek i zoti.

Fatura për të kthyer vlerën e plotë pronarëve të shpronësuar nga regjimi komunist apo nga 7501 post-komunist, është mbi 8 miliardë euro.

Ne jemi të vetëdijshëm se pa një mekanizëm që zhbllokon këtë situatë një herë e mirë, Shqipëria mbijeton por nuk mund të zhvillohet.

Sipas parimit “UTI POSSIDETIS” – “ASHTU SIÇ ËSHTË” ne marrim përsipër brenda 2 viteve të para të qeverisjes së re, krijimin e obligacionit për pronarët me vlerën e plotë të tregut për të gjithë pronat e shpronësuar të regjimit komunist të pagueshme çdo vit në masën 1/20, të

tregtueshme që nga moment i emetimit, emetim me vlerë të plotë i obligacionit të shtetit shqiptarë për të gjithë pronarët e shpronësuar të Shqipërisë.

Për të gjithë ata të shpronësuar nga regjimi komunist, për të gjithë ata që e shohin por nuk e prekin dot pronën për shkak të 7501-it, për të gjithë ata të cilët pronën e kanë parë të zënë e të zhvilluar gjatë procesit të ndërtimeve informale, me një të rënë ne do të marrim përsipër jo vetëm barrën financiare të konsiderueshme por dhe zgjidhjen e problemit të titujve sipas parimit *Uti Possidetis*: kush e ka e gëzon, kujt i është zënë do të shpërblehet me vlerën e tregut me obligacionin shqiptar për pronarët.

Dita kur kjo reformë e munguar do të përmbillet, është dita e parë e Shqipërisë së zhvilluar, është dita e parë e shqiptarëve të lirë, është dita e parë e Shqipërisë evropiane.

Kjo do të bëjë të mundur që qeveria përmes taksës së pronës, përmes të ardhurave të rritura për shkak të luftës kundër informalitetit, të adresojë prioritete të rëndësishme duke nisur me fermerin shqiptar.

Angazhimi ynë është:

- çdo vit 100 milionë euro subvencione për fermerin shqiptar;
- çdo vit 50 milionë euro zhvillim infrastrukture për fermat dhe zhvillimin rural në të cilën përfituesit do të jenë fermerët shqiptarë;
- 150 mijë familje fermere, do të përfitojnë dhe do të dalin nga varfëria dhe nga stanjacioni ku i ka përfshirë Edi Rama dhe qeverisja e tij.

Bujqësia meriton më shumë, fermerët meritojnë më shumë dhe do të kenë mbështetjen që meritojnë.

Në qeverinë e re, ne do të bëjmë:

- Konsolidim të kuadrit ligjor për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes së trajtimit të pronës;
- Krijim të një databaze për vendimet përfundimtare, sipas Ligjit të Pronës;
- Rishikim të hartës së vlerës, duke e bërë atë unike dhe të njëjtë për të gjitha rastet e trajtimit të pronave;
- Përcaktim i saktë i faturës financiare për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare.

Nëpërmjet kësaj skeme do të bëhet e mundur:

- Kthimi fizik i plotë i pronës;
- Kompensimi fizik me një tokë tjetër të barazvlefshme në vlerë;
- Konsolidimi i fondit të tokave për kompensim fizik, duke përfshirë:
 - Tokat e kaluara në inventarin e pushtetit lokal;
 - Pronat e konfiskuara sipas ligjit antimafia;
 - Pronat që rrjedhin nga kontrata PPP apo koncesione korruptive;
 - Kompensimi në vlerë tregu për pronat e pakthyeshme, përmes obligacioneve shtetërore të emetuara posaçërisht për këtë qëllim;

- Thjeshtëzimi i procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës.

Të Përndjekurit Politikë

Për të Përndjekurit Politikë, forca jonë zotohet përpara kësaj shtrese se në qeverisjen e re ne do të mundësojmë:

- Pajisjen me statusin e të Përndjekurit, për të gjithë të pushkatuarit, burgosurit dhe të internuarit politik;
- Trajtimin e statusit financiar të të përndjekurit politik, të barazvlershëm me statusin e ish-ushtarakut;
- Zgjatjen e afateve për shqyrtimin e mbi 2000 dosjeve të mbetura pezull;
- Mbështetjen e Institutit të Kujtesës dhe Studimeve të Krimeve të Komunizmit për rritjen e ndërgjegjësimit kombëtar;
- Rishikimin e teksteve shkollore mbi baza shkencore dhe arkivore;
- Promovimin e “Librave të Ndalar” dhe mbështetja për dorëshkrime të papublikuara të autorëve të persekutuar;
- Hartimin e ligjeve për:
 - Informimin mbi të kaluarën komuniste;
 - Lustracionin për pastërtinë e figurave publike.
- Krijimin e Muzeut Kombëtar të Kujtesës dhe kthimin në muze të kampeve-burgje të Spaçit, Qafë-Barit dhe Tepelenës;
- Rikthimin e pronave të konfiskuara ose kompensimin me vlerën e tregut.
- Mbështetjen shëndetësore dhe subvencionim për të përndjekurit e moshës së tretë.

Brenda mandatit të parë do të përmbyllet dëmshpërblimi i plotë për këdo që është gjallë nga të përndjekurit, duke ndjekur kriterin e moshës.

9. ART / KULTURË / SPORT

Programi për artin, kulturën, trashëgiminë e kulturës dhe të mendimit ka si qëllim strategjik të shndërrojë artin, kulturën dhe trashëgiminë tonë kulturore në një industri kreative funksionale, të integruar dhe konkurruese, me ndikim të rëndësishëm social dhe ekonomik për të gjithë shqiptarët.

Shqipëria meriton më shumë, shqiptarët meritojnë më shumë, ndaj objektivi politik i programit tonë është: “Art dhe kulturë e aksesueshme për çdo qytetar, jo vetëm si një e drejtë humane, por si një faktor themeltar për një shoqëri më të shëndetshme, më tolerante dhe gjithpërfshirëse”.

Në qeverinë e re ne do të garantojmë:

- Rritjen progresive të buxhetit për Artin, Kulturën dhe Trashëgiminë e Kulturës në masën 50 milion euro;
- 0% taksë për individin krijues, për të nxitur krijimtarinë në sektor të industrisë creative;
- RINFOND – do të jetë fondi prej 1 MILION euro, i dedikuar për artistët e rinj në të gjitha fushat e krijimtarisë sepse të rinjtë tanë meritojnë më shumë, ata duhet të shkëlqejnë me artin dhe talentin e tyre në Shqipëri;
- Rritjen në masën 5 MILION euro e buxhetit për KINEMATOGRAFINË duke synuar me këtë, Prodhimin, Promovimin dhe Distribuimin e produktit kinematografik shqiptar;
- Krijimin për herë të parë të mekanizmit të rimbursimit për të gjithë investitorët e huaj në kinematografi në masën 35% (mekanizmi i njohur si Tax Credit ose Tax Rebate);
- 10 fishimin e të ardhurave që gjenerohen nga industria kreative të lidhura me të drejtën e autorit nga 0.7 mln euro që është sot synojmë 7 milionë euro, përmes Strategjisë Kombëtare për zbatimin e “Ligjit për të Drejtën e Autorit”.

Krijimi dhe themelimi i institucioneve të reja, me më shumë kompetenca dhe pavarësi në zhvillimin e aktivitetit artistik, është domosdoshmëri për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Koalicioni Euroatlantik në qeverinë e re angazhohet për rivitalizimin e Qendrave të Artit për Fëmijë dhe të Rinj në të gjitha Bashkitë e vendit.

Gjithashtu, ne do të ngrejmë dhe themelojmë institucionet e reja:

- Qendra Kombëtare të Artit Bashkëkohor (QKAB)
- Qendra Kombëtare e Artit Shqiptar
- Fondacioni për Letërsinë Shqipe
- Fondi për Kreditim në Kulturë
- Agjencia e Librit Shqip
- Teatër i ri për artistët e rinj të arteve të performuara
- Teatër Alternativ
- Galeria Impresionizmit Shqiptar “Vangjush Mio”.

- Ne do t'ju japim statusin e Teatrit Kombëtar teatrove:
- Teatrit “Migjeni” Shkodër,
- Teatrit “Andon Zako Çajupi” Korçë,
- Teatrit “Petro Marko” Vlorë.

Trashëgimia kulturore

Trashëgimia jonë kulturore jo materiale është jo vetëm testamenti historik ndërbreznor, por edhe pasaporta më e fuqishme e integritetit në qytetërimin perëndimor të cilit i përkasim.

Vallja Pirrike, apo Çame e Osman Takës, Kcimi Vendçe, Logu i Bjeshkëve, Kanuni i Lek Dukagjinit, Monofonia ose Kanga Majë' Krahut, Gjama e Burrave krahas Këngës shumëzërëshe e Iso Polifonisë, etnografia jonë e veçantë, Plisi, Xhamadani e Fustanella Shqiptare, Xhubleta Mirditore, krahas Xhubletës Shqiptare dhe pasuri të tjera jo materiale duhet jo vetëm të konservohen me origjinalitetin e tyre por dhe të trajtohen si margaritarët e paprekshëm në trupin e kombit tonë, si njëri nga kombet më të lashtë të kontinentit.

Edhe në rrafshin kombëtar pasi ne jemi një komb etno-kulturor lipset një strategji unike efektive për të materializuar bashkimin tonë shpirtëror e kulturor gjithmonë në kuadrin e integritetit evropian.

Sporti

Shqiptarët njihen për vitalitetin, forcën, vendosmërinë, pasionin, natyrën konkurruese e dëshirën për të fituar apo sfiduar.

Programi ynë për sportin përfshin edhe rishikimin e ligjit të sponsorizimit. Aplikueshmëria e këtij ligji do të ketë një impakt të menjëhershëm.

Ne do të rishikojmë ligjin e sponsorizimit për:

1. Rritjen e buxhetit për sportin;
2. Ndërtimin e terreneve të reja sportive;
3. Restaurimin e infrastrukturës aktuale sportive;
4. Rikthim të dinjitetit për sportistët, me reforma që përfshijnë privatizimin e klubeve dhe rritjen e pagave;
5. Punësimi të 1500 trajnerëve të rinj në arsimin parauniversitar, duke mbështetur familjet që aktualisht shpenzojnë deri në 2000 € në vit për trajnime private.

10. SHQIPËRIA EUROATLANTIKE/ INTEGRIMI NË BE / SIGURIA KOMBËTARE

Ashtu si antarësimi në NATO, si koalicion euroatlantik, ne vlerësojmë se integrimi evropian është prioritet shtetëror dhe kombëtar. Integrimi evropian sot është jo vetëm një çështje standardesh modernizuese të shtetit, por dhe një çështje sigurie në mbrojtje të hapësirës së vlerave të botës demokratike ku duam të bëjmë pjesë. Prandaj, ne gjithmonë kemi mbështetur dhe kemi nxitur pa asnjë kusht rrugëtimin evropian të Shqipërisë.

Ne angazhohemi, për marrëdhënie të shkëlqyera me të gjithë vendet anëtare të NATO-s dhe BE-së, me të cilat do të bashkëpunohet intensivisht, duke vazhduar forcimin e këtyre marrëdhënieve në kuadër të institucioneve ndërkombëtare dhe në rrafshin bilateral në fusha me interes reciprok, veçanërisht ato politike dhe ekonomike.

Në funksion të sigurisë sonë kombëtare, në qeverinë e re ne do të garantojmë:

- Zhvillimin e partneriteteve strategjike me vendet e aleancës për vlerësimin e përbashkët të rreziqeve dhe kërcënimeve në hapësirën Euro-Atlantike;
- Themelimin e Komandës së Mbrojtjes Kibernetike, për të siguruar funksionimin e infrastrukturave kritike dhe hapësirën kibernetike të Forcave të Armatosura dhe partnerëve të NATO-s në Shqipëri;
- Krijimin e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare deri në vitin 2029, si një institucion koordinues për sigurinë dhe inteligjencën;
- Rritjen e shpenzimeve reale për mbrojtjen, duke mbështetur politikat e NATO-s dhe interesat e sigurisë kombëtare;
- Fuqizimin e kapaciteteve të mbrojtjes, në bashkëpunim me Kosovën, si një udhërrëfyes për forcimin e sigurisë rajonale;
- Mundësimin e shërbimit aktiv për të paktën 5000 djem dhe vajza, për një periudhë minimale prej 4 vitesh. Gjatë kësaj kohe, ata do të studiojnë me shpenzimet e Forcave të Armatosura, të marrin profesion dhe të shërbejnë si rezervistë deri në moshën 45 vjeçare.

Partneriteti strategjik Euroatlantik

Marrëdhëniet strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë thelbësore për zhvillimin dhe sigurinë tonë. Koalicioni Euroatlantik:

- Angazhohet për heqjen e vizave me SHBA-në brenda mandatit të parë qeverisës, ashtu siç hoqëm vizat për zonën Shengen;
- Marrëdhëniet me Britaninë e Madhe dhe vendet anëtare të BE-së do të kenë një dimension të ri, për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të cilësisë së jetesës së qytetarëve;
- Integrimi Evropian mbetet prioritet kombëtar. Ai nuk është vetëm një çështje standardesh, por edhe një çështje sigurie dhe ruajtje e vlerave demokratike.

Prioritet Interesat Shqiptare në Rajon

- Mbështetje të nismave rajonale që promovojnë integrimin euroatlantik, si Procesi i Berlinit dhe dekurajojmë çdo iniciativë që devijon nga parimet e BE-së;

- Mbrojtje të integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës, si dhe konsolidimi i shtetit të saj demokratik, do të jetë prioritet kyç në marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare;
- Mbështetje të fuqizimit të përfaqësimit institucional të faktorit politik shqiptar në vendet fqinje;
- Ruajtje të gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar, përmes ngritjes së Institutit të Gjuhës dhe Kulturës Shqiptare, me një rrjet filialesh në diasporë.